

FDH-5690; deklarata S.V, FDH-5691; deklarata D.S, FDH-15364; AFPRRZHKeM, *Regjistri i personave..*, FDH-16116; *Osmi slava bez domačina*, Oteta istina, num. 10, janar-qershor 2007, 35, FDH-30365.

Krsta (Budimir) Stanojević

(5.09.1960, serb nga Rahoveci/Orahovac)

Krsta punonte si shtëpiak në shkollën fillore *Dositej Obradović* në **Rahovec/Orahovac**. Me bashkëshorten Jasnen u kujdeseshin për dy djem binjakë, të cilët i kishin adoptuar. Kur, në mbrëmjen e datës 17.07.1998, UÇK-ja e vendosi kontrollin e saj mbi Shtëpinë e Shëndetit, Jasna ishte në mesin e stafit mjekësor. Ditën e diel, më **19.07.1998**, Krsta shkoi në Shtëpinë e Shëndetit për ta kërkuar bashkëshorten. Ushtarë të UÇK-së e ndaluan dhe, më pas, e çuan në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Nga ky burg, ai dhe të burgosurit e tjerë serbë, të cilët ishin nga Opterusha/Opteruša dhe Retia/Retimlje [të shikohen regjistrimet], u dërguan më 26.07.1998, në drejtim të Prishtinës/Priştina. Mbetjet mortore të tij janë zbuluar në varrezën masive në Volljakë/Volujak, në muajin prill të vitit 2005. Pas përfundimit të procedurës së identifikimit me analizën e ADN-së, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Krstes në kishën ortodokse në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.G, FDH-465; deklarata J.S, FDH-3899; deklarata S.B, FDH-5513; deklarata N.N, FDH-5519; deklarata J.S, FDH-5676; deklarata S.S, FDH-5690; deklarata S.V, FDH-5691; deklarata D.S, FDH-15364; AFPRRZHKeM, *Regjistri i personave..*, FDH-16116; *Osmi slava bez domačina*, Oteta istina, num. 10, janar-qershor 2007, 35, FDH-30365.

Hasan (Hajrullah) Bugari

(9.04.1949, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, kuvar, tre fëmijë)

Bekim (Hasan) Bugari

(26.01.1971, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, dy fëmijë)

Bedri (Sabedin) Bugari

(15.04.1971, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar)

Kujtim (Isuf) Isma

(5.09.1979, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac)

Familja e Kujtimit ishte e varfër. Shtëpinë e tyre të vogël në vendin e quajtur *Te Rrasat/Ploče* ua kishte ndërtuar axha i babait të Kujtimit. Përball tyre, jetonte Hasani me familje. E kishin shtëpinë e madhe dhe të bukur. Në orët e hershme të mëngjesit, më **18.07.1998**, nëna dhe motra e Kujtimit e braktisën Rahovecin/Orahovac dhe shkuan në fshatin Astrazub/Oštrozub. Kujtimi dhe i ati u strehuan në bodrumin e shtëpisë së Hasan Bugarit. Përpos Hasanit, në bodrum me ta ishin edhe djali i Hasanit, Bekimi, dhe djali i vëllait të tij, Bedriu. Familjarë të tjerë të Hasanit ishin arratisur më herët nga qyteti. Rreth orës 16:00, ishte rritur intensiteti i të shtënave në qytet, ndërkaq predhat dhe plumbat vinin nga të gjitha anët. Të strehuarit në bodrum vendosën të arratiseshin nga qyteti. E bënë planin që të dilnin në rrugë kryesore, pranë pikës së karburanteve të *Haxhijahës*, dhe, më pas, të kalojnë në pyll. I kaluan vetëm afro 200 metra drejt lagjes *Dogana/Carina* [**Rahovec/Orahovac**], kur mbi ta u hap zjarri nga një shtëpi e pa përfunduar. Bekimi, Bedriu, Kujtimi dhe Hasani u qëlluan për vdekje në vend, ndërkaq Isufi u plagos rëndë. Trupat e Bekimit, Bedriut, Hasanit dhe të Kujtimit, policia i ka marrë me vete më 20.07.1998. dhe i ka varrosur në varrezat e Prizrenit/Prizren. Pas përfundimit të luftës, më 17.07.1999, mbetjet e tyre mortore janë zhvarrosur dhe, më pas, janë varrosur po atë ditë, në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-881; deklarata J.I, FDH-20098; deklarata I.I, FDH-33630; KMKRKFJ, *Personat..*, FDH-10832.

Svetozar (Đorđe) Tomić

(14.02.1946, serb nga Gjakovë/Đakovica, bankier, tre fëmijë)

Svetozari ka qenë drejtor i filialit të *Jugobankës* në Gjakovë/Đakovica. Ditën e shtunë, më **18.07.1998**, herët në mëngjes, Svetozari e ka çuar me makinë bashkëshorten në Prizren, nga ku e vazhdoi rrugën për në **Rahovec/Orahovac**, për të kontrolluar banesën dhe vizituar farefisninë. U zhduk në